

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

14.11.2023
Ora 12:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z.Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj.P.Docaj**

• **Parti Politike: Z.A.Kaziaj, Z.F.Nuri (Bashkë fitojmë)**

Të tjerë: KRIIK, Avokat Z.A.Llongozi, Z. Th.Sallaku

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve. Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend të ditës disa projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave në Këshillin e Bashkisë Pukë, Shijak, Tiranë, Devoll. Gjithashtu kemi projektvendimin për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zoti Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat dhe nga seancat e kaluara kemi dy çështje miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituar dhe të shpenzuar nga partitë politike për vitin kalenderik 2021. Miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore

***Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

të datës 6 Mars 2022. Mendoj që të fillojmë në radhë të parë me çështjen që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetdeklarues zotin Kreshnik Hajdari, Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Po fjala për ju zoti sekretar për të relatuar.

Z.Y.Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin e verifikimit zbatim ndalimeve për zgjedhje dhe emërimit për funksionet publike si dhe prokurimit për formularit të deklarimit të disa subjekteve në të cilët dhe kryetari i bashkisë. Në zbatim të këtyre dispozitave zoti Kreshnik Hajdari Kryetari i Bashkisë Kuçovë ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit me numër unik 17 mijë e 366 dhe KQZ-ja ka bërë verifikimin paraprak dhe ka konstatuar se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave informale të deklarimit konstatohet se subjekti deklarues nuk ka deklaruar në ato që ka të bëjë me ndalimin e ligjit nr 138 të vitit 2015. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 04.04.2023, është paraqitur kërkesa nga subjekti politik koalicioni Bashkë Fitojmë për verifikimin sipas figurës së zotit Kreshnik Hajdari pasi ka të dhëna që ky subjekt ka qenë i dënuar në shtetin Grek. Nga konstatimet e mësipërme bazuar në nenin 8 pika 1 e ligjit 138 e vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dërguar rastin për të verifikuar Prokurorisë së Përgjithshme. Në datën 02.11.2023 Drejtoria e Koordinimit Institucional Sektori i Dekreminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetdeklarues të zotit Kreshnik Hajdari për të cilën konstatohet se nuk do të ketë gjenalitete të tjera në përbërëse të Gjendjes Civile. Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë Gjykata Penale me një anëtar. Në

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

listën e të pandehurve është numri 14 Kreshnik Hajdari me bashkëgjykuar i mitur thotë ka shpallur fajtor për hyrjen në territorin grek pa formalitete ligjore përkatëse pika 8 e ligjit nr.1981 të Kodit Penal Grek. Gjithashtu e dënon secili nga të pandehurit të mitur e ka shpallur fajtor me masën riedukuese të qortimit. Nuk rezulton i dënuar me vendim penal gjyqësor jo përfundimtar të Autoritetit Gjyqësor shqiptar ose të huaj. Rezulton se ka qenë gjykim nga gjykata e Shkallës së Parë Janinë dhe nuk rezulton të jetë i ndaluar apo i arrestuar nga organet e dispastuese për kryerjen e veprës penale nuk rezulton të jetë ndaj tij të caktuar një masë shtrënguese, nuk rezulton të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar si dhe nuk rezulton ndaj tij dhe të marrë masë e dëbim nga një shtet i huaj. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shyqrtim dhe miratim si dhe vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatin të verifikimit të thelluar.

Z.I.Celibashi: Faleminderit. I jap fjalën fillimisht palës së interesuar subjektit vetdeklarues kryetarit të bashkisë, ose përfaqësuesit së tij ligjor.

Z. Th.Sollaku: Në vlerësimin tonë nuk ka asnjë shkak për t'u justifikuar ndërprerjen e mandatit të zotit Kreshnik Hajdari edhe çfarë pretendohet nga personat që kanë inicuar këtë procedurë administrative rezulton që në vitin 1999 kur Kreshnik Hajdari ishte në moshën 16 vjeç është kapur nga autoritetet greke për kalim të paligjshëm të kufirit. Është bërë një procedurë e cila nuk dihet ka qenë kanale, ka qenë administrative dhe më së fundi është marrë masa qortim shoqëror dhe ndërkohë janë larguar nga territori grek brenda 24-orëve. Në këto kushte në qoftë se fabula është kaq dhe kaq rezulton edhe nga çfarë ka verifikuar organi i Prokurorisë së Përgjithshme ne mendojmë se nuk takohen asnjë nga rastet ndaluese të ligjit dekriminalizimit, sepse edhe sikur t'i marrim të mirqëna dhe që nuk janë të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

vërteta ndodhin para veprës penale të parashikuar nga Kodi Penal neni 297, çfarë nuk përfshihet në kategorinë e veprave që të ndalojnë për të ushtruar një funksion shtetëror. Kaq kisha unë, të tjerat mendoj se nuk është vendi dhe nuk jemi organi për t'u shqyrtuar dhe për të marrë vendim. Pra ne mendojmë se nuk ka asnjë shkak për ato që pretendohen nga inicuesit në këtë procedurë. Faleminderit.

Z.I.Celibashi: I japim fjalën përfaqësuesit politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve zotin Kaziaj.

Z.A.Kaziaj:Faleminderit për fjalën themi që nuk dakortësoj për atë qëndrim të mbajtur nga ana e kolegut Sollaku në këtë rast flasim për një document shtetëror të komunikuar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme si organ kompetent me numër protokolli 601/35 të vitit 2023 për miratimin e rezultateve të verifikimit. Nga brendia e tij zoti Komisioner tashmë të gjithë ju keni marrë dijeni për brendinë e këtij dokumenti veç faktit një procesi gjyqësor të formës së prerë të vitit 1999 ndërmjet të cilit zoti Hajdari është dënuar me vendim siç e thashë të formës së prerë. Vetë Prokuroria relatton dy fakte të tjera të karakterit të detyrueshëm për t'u sinjalizuar në atë që është formulari i dekriminalizimit referuar asaj që është dëbimi në vetvete i shtetasit për këtë vendim të sapo cituar dhe së dyti referuar faqes 4 citoj Prokurorinë e Përgjithshme thotë: shtetasi i mësipërm është regjistruar në datën 27.03.2017nga Security Sapt Divizion of Janina pasi është deportuar në Shqipëri. Këtë ifnormacion mesa relatton më sipër Prokuroria e Përgjithshme ka marrë nga Interpol Tirana ndërmjet të cilit është vënë informacioni nga Interpol Athina në këtë rast. Flasim veç ndalimit ose detyrimit për ta sinjalizuar dhe për ta caktësuar në i huaj flasim dhe për një dëbim të dytë nga një shtet i huaj sipas referencave që unë sapo citova. Pra në këtë rast ndonëse në faqen e fundit ka bërë

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

një lapsus Prokuroria e Përgjithshme ku thotë te pjesa që vendos Prokurori i çështjes që është marrë nga verifikimi e gjetjeve nuk rezulton thotë që ndaj tij të jetë marrë masë e dëbimit nga një shtet i huaj. Ndërkohë që vetë prokurori që ka përpiluar këtë dokument thotë që ka pasur dy raste dëbimi kështu që në kushtet e një praktike tashmë të konsoliduar të këtij institucioni i nderuar zoti kryetar, me raste analoge më shumë se një rast në kushtet e një vendimmarrje të themi edhe të Gjykatës së Lartë që kolegët më vonë do ta citojnë me numër vendimi për analogji dhe me datë. Në këtë rast jemi kryekëput nga këto që janë parashikimet e ligjit për ndalimin e ushtrimit të funksionit publik për shkak të mos deklarimit në formularin e dekriminalizimit. Faleminderit.

Z.I.Celibashi: Po Franci?

Z.F.Nuri: Faleminderit zoti kryetar, ne e kemi depozituar si koalicioni Bashkë Fitojmë kërkesën që në muajin Prill të vitit 2023 dhe e prisim sot të vinim në këtë fazë pavarësisht se e kishim kërkuar dhe atëherë këtë lloj mbledhje po sikundër të gjithë e dimë duhet që informacioni duhet të vinte dhe në rrugë zyrtare në KQZ ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme ne qëndrojmë si koalicion iniciues e kësaj procedure mendimi dhe i qëndrimit se mandati duhet ndërprerë menjëherë për shkaqe si vijon: Nuk ka rëndësi masa apo lloji i dënimit, ajo që ka rëndësi sipas ligjit është nëse ky dënim është deklaruar apo jo në formular. Pyetja juridike që shtrohet sot është : A është i dënuar zotëria me vendim të formës prerë dhe përgjigja e Prokurorisë së Përgjithshme thotë se po. Pyetja e dytë a ka deklaruar zoti Hajdari këtë dënim të formës së prerë në formularin e detyrueshëm të deklarimit? Përgjigja është jo. Pyetja e fundit çfarë parashikon ligji në këtë rast ligji i kriminalizimit dhe vendimi i Kuvendit që skon bashkë me ligjin e

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

dekriminalizimit pra përkatësisht formularin. Çfarë parashikon parashikon ndërprerjen të menjëhershme të mandatit për shkak të mosdeklarimit të një dënimi penal të formës së prerë qoftë dhe një dënim administrativ merreni si të doni është një vendim i formës së prerë i një gjykate të huaj që Prokuroria e Përgjithshme sot e konfirmon që ka ekzistuar dhe ne konstatojmë shtë fare e qartë nuk është deklaruar, duhet të ishte deklaruar dënimi masa lloji i saj ndoshta në vetvete mund të jetë një dënim relativisht i ulët pak rëndësi ka kjo. Pyetja sot është pse nuk është deklaruar dhe duhet të ishte deklaruar kjo gjë në mënyrë që mandati të vazhdonte. Fakti që ky dënim ky fakt është mohuar, nuk është deklaruar në formular të gjithë e dijnë që përbën vepër penale falsifikimi i formularëve. Kështu që ne i qëndrojmë idesë dhe mendimit që aq më tepër se zotëria ka qenë dhe prezent në sallën e gjyqit sipas vendimit të ardhur nga autoritetet greke dhe ka pasur dijeni për këtë gjë. Pra edhe një herë pak rëndësi ka masa e dënimit ka qenë me gjobë, ka qenë me qortim nuk ka rëndësi fare rëndësi ka që vendimi është i formës së prerë dhe nuk është deklaruar dhe sikundër kolegu e parashtroi KQZ-ja ka pasur raste të ngjashme në të shkuarën precedent rasti i zotit Kajmaku që po ashtu ka pasur probleme me autoritetet greke në të shkuarën, nuk kishte rëndësi masa e dënimit dhe në atë rast për ndërprerjen e mandatit kishte rëndësi që ajo nuk ishte pasqyruar saktë në formular mos gaboj ka pasur raste e zotit Nuredini, rastet e zotit Roshi etj që kanë qenë dhe minoren që kanë pasur apo jo dijeni ka kuptuar gjuhën apo jo pak rëndësi ka kjo për ligjin e dekriminalizimit dhe vendimin e Kuvendit që i bashkëngjitet. Ajo që ka rëndësi dhe një herë për ndërprerjen ose jo të mandatit në këtë rast është nëse ky vendim i formës së prerë është apo jo i deklaruar nëse nuk është deklaruar ky vendim i bie që është fshehur. Kolegu do të parashtrojë tashmë dhe do të depozitojë si provë një vendim të Gjykatës së Lartë të muajit Korrik 2023 ku Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim mjaft të qartë në intepretim të kësaj

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

pyetje juridike dhe të këtij problem juridik ku e thotë mjaft qartë Gjykata e Lartë se pak rëndësi ka masa dhe lloji i dënimit rëndësi ka është deklaruar apo jo.

Z.I.Celibashi: Faleminderit.

Z.A.Llongozi: E kam autorizimin nga Koalicioni Bashkë Fitojmë. Tani këtu jemi mbledhur për faktin se zoti Hajdari nuk ka treguar ose nuk ka deklaruar në formularin e vetdeklarimit një dënim penal, por njëkohësisht nuk ka pasqyruar edhe një dënim në vitin 2017 kur ka qenë madhor dhe ka qenë lëvizja e lirë në të gjithës europën. Për këto dy fakte sepse indicia ka qenë vetëm për faktin se ka pasur një dënim penal por nga verifikimi i Prokurorisë së Përgjithshme ka rezultuar se zoti Hajdari është dëbuar nga shteti grek në vitin 2017 muajin Mars data 17. Pra është fakt dhe ndodhet provë në dosje. Nëse ne i referohemi ligjit kolegët e shprehën fare qartë kemi një formular vetdeklarimi jo të saktë dhe duhet të konstatohet pavlefshmëria e tij. Por meqënëse zoti Hajdari në kohën kur deklaroi nuk e kishte deklaruar këtë gjë mund ta deklarojë tani se meqënëse është prezent se nuk mund të vish këtu e të thuash nuk di gjë se çfarë ka ndodhur në atë kohë ke detyrim t'ia thuash të gjithë popullit, mediave dhe të gjithë publikut atë fakt që të ka ndodhur e kemi present ta deklarojë që si ka qenë e vërteta të bindemi ndoshta është ndryshe. Gjithsesi zoti Hajdari nuk mendoj se do ta thotë këtë gjë por nëse ne i referohemi Kolegjit të Lartë të Gjykatës së Republikës së Shqipërisë vendim penal datë 24.07.2023 në paragrafin 22 i këtij vendimi është e përcaktuar në një mënyrë të qartë. Po ju citoj vetëm një paragraf shumë i shkurtër referuar përmbajtjes së formularit të vetdeklarimit i dalë në zbatim të ligjit 138 i vitit 2015 I miratua me vendimin nr.17 2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Kolegji vlerëson se subjektet deklaruese që përcaktohen në këtë ligj kanë detyrim të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

pasqyrohen në formular çdo dënim penal të formës së prerë të dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo të huaj pavarësisht llojit dhe të veprës penale llojit të masës dënimit të dhënë madje në rubrikën maj e dënim mbi efektet e formularit të vetdeklarimit pikën b parashikohet se kemi të bëjmë me vepër penale. Pra zoti Hajdari jo vetëm se nuk e ka deklaruar është përgjegjës për një vepër penale dhe jo vetëm nga ky institucion duhet të konstatohet pavlefshmëria e mandatit por ne i kërkojmë që të depozitohet dhe kallëzim penal sepse referuar nenit 281 vijues të tij kemi të bëjmë me një vepër penale të konstatuar dhe duhet të kallëzohet nga cilido punonjës i administratës shtetërore. Ky vendim i nderuar është edhe në pikën 24, 25 të tij që sqaron në mënyrë shtetërore të gjithë intepretimet se në qoftëse se paska qenë i dënuar për kalim të paligjshëm të kufirit duhet të favorizohet jo sepse nuk duhet të favorizohet në asnjë pikë se ligji nuk i referon zotit Hajdari nëse e vlerëson ta deklarojë apo jo, por institucioneve të shtetit shqiptar janë ata persona ose është ai institucion që duhet të vlerësojë nëse ka kushte ndaluese apo jo. Në rastin aktual nuk jemi te fakti që meqënëse ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshëm nuk ka kusht ndalues. Nuk jemi para këtij fakti por jemi përpara një veprimi juridik të pavlefshëm i vërtetuar aktualisht dhe institucioni juaj KQZ në rastin aktual ka detyrimin ligjor të konstatojë pavlefshmëri referuar qoftë ligjit përkatës neni 10, qoftë edhe vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Vendimi është në formën e kërkuar nga ligji kërkohet që të merret, sepse nuk mendoj që institucioni KQZ-së duhet të jetë sipër Gjykatës së Lartë. Atëherë në qoftë se do të jetë sipër Gjykatës së Lartë kërkojmë që të gjitha vendimet e Gjykatës së Apelit t'i referohen KQZ-së aktualisht, janë detyruese këto vendime qoftë për ne si avokatë qoftë për institucionet qoftë për gjykatat vetë dhe jo më për kolegjin tuaj. Përfundimisht i kam parashtruar me shkrim të shpallë të pavlefshëm

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë Kreshnik Hajdari kam parashtrime 6 faqe e kam të shtjelluar.

Z.I.Celibashi: Faleminderit. Përfaqësuesi i subjektit?

Z.Th.Sallaku: Lidhur me referencën e jurispodencën e Gjykatës së Lartë ne mund ta kundërshtojmë këtë që sapo tha parafolësi me një rast identik që është si rasti ynë rasti i Qerim Ismailit është një vendim që flet në favorin tonë dhe bie në kundërshtim me ato që sapo tha parafolësi. Lidhur me problematikat që ngriti përfaqësuesi i palës iniciuese të këtij procesi a është dënuar apo jo. Kemi një vendim dënim qortim shoqëror në ato vite në vitin 1999 Kodi Penal nuk ka pasur dënime të tilla. Në janar të vitit 2018 është miratuar ligji Kodi për Drejtësinë Penale për të miturit. Aty janë parashikuar disa masa të ngjashme me këtë lloj ndrimi dhe në finale ligjvënësi me këtë ligj ka parashikuar që në qoftë se merren masa të tilla, të cilat parashikon neni 62 të këtij ligji quhet person i padënuar pra Prokuroria nëse ndesh një situatë që parashikon ky ligj është detyruar ta mos qëlloj por në se nuk e ka bërë Prokuroria atëherë duhet që Gjykata duhet ta pushoj çështjen. Pra janë argumente mendojmë që në këtë rast edhe sikur të pranohet çfarë kanë inicuar ne e vlerësojmë që nuk quhet i dënuar për këto argumente. Për sa i përket rastit të dëbimit në vitin 2017 duhet lexuar qartë dhe ajo. E para ne nuk kemi dijeni sepse janë informacione policore të cilat nuk u jepen individit dhe ai më pas tregohet i sinqertë për të deklaruar në fomrularin përkatës, por aty është thënë që në vitin 2017 është hedhur në sistem kjo situatë e ndodhur në vitin 1999. Kqa mendoj dhe nuk mund të penalizohet zoti Kreshnik Hajdari lidhur me sa pretendojmë shtesë nga ana e inicuesve.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

Z.I.Celibashi: Po?

Z.F.Nuri: Një ndërhyrje të vogël i nderuar në lidhje me argumentin që sapo dëgjuam për Kodin Penal të Shqipërisë mos gaboj që nuk e paska parashikuar në dispozitat e tij këtë lloj vepre penale, doja t'ia rikujtoj të gjithëve që këtu nuk jemi përpara një seance për konvertim dënimesh apo me një lloj rasti ekstradimi ku duhet ku Gjykatës Shqiptare të shprehen nëse në juridksionin tonë ligji jonë parashikon një dënim të ngjashëm apo etj. Vetëm në këto raste mund të shihen Kodi ynë Penal nëse e ka të parashikuar këtë lloj dënimi apo jo. Në rastin konkret nuk ka lidhje fare ajo se çfarë ne po diskutojmë. Ne po diskutojmë nëse formulari është plotësuar në mënyrë korrekte apo nëse nuk është prononcuar në mënyrë korrekte nëse ky vendim është i formës së prerë le të jetë vendimi i Gjykatës të Janinës administrative apo penal nuk ka rëndësi është i formës së prerë apo jo kjo është ajo që ne duam dhe a është deklaruar apo jo nëse nuk është deklaruar vendimi ne nuk po i hymë legjislacionit grek për të thënë që ka qenë masë e vogël apo masë e rëndë apo ka qenë ndonjë element tjetër. Nuk po diskutojmë fare këtë aspect aspektin që po diskutojmë dhe një herë në KQZ është a është deklaruar saktë formulari nëse po apo nëse jo pasojat pastaj variojnë.

Z.I.Celibashi: Po zoti Kaziaj.

Z.A.Kaziaj:Faleminderit zoti Celibashi, orientimi që i bën kolegu mbrojtës i zotit Hajdari duke futur në rrugë shkurtësinë e atij që është ligji penal ose Kodi Penal për Drejtësinë për të mitur nuk ka të bëjë në vetvete me thelbin e kërkesave të ligjit ndalues në këtë rast për mos deklarimin e të dhënave të sakta në formular. Orientimi që kolegu i bën duke saktësuar se ajo që është evidentimi i Prokurorisë

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

së Përgjithshme për regjistrimin në datën 27. 03.2017 nga Security Sabdivizon Of Janina qenka me datë ekspost për dënimin e dhënë në vitin 1999. Meqë jemi në këtë dyshimin e fundit të paktën se për ne është qartësi nuk është dyshim po meqë kolegu Sollaku e paska si dyshim është vetë shtetasi Hajdari në këtë sallë dhe të na përgjigjet pak në qoftë se ka dijeni për ndonjë dëbim të datës 27.03.2017.

Z.A.Llongozi: Doja të shtoja diçka i nderuar, nëse i referohemi shkresës që është paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhor Prokuroria e Përgjithshme e ka konstatuar se Vepra penale e dënuar për shtetasin Kreshnik Hajdari është e parashikuar dhe në Kodin tonë Penal dhe e kemi në shkresë është konstatuar nga Prokuroria e Përgjithshme, por për analogji i nderuar kemi dhe një rast tjetër meqënëse na u përmend Qerim Ismaili për fat është avokati që përfaqëson dhe zotin Hajdari në këtë séance. Kemi dhe rastin e zotit Elvis Roshi që është përfaqësuar po nga avokati është lënë në fuqi dhe nga Gjykata Kushtetuese shkarkimii tij për të njëjtin fakt dhe mendoj se vendimi i Gjykatës Kushtetuse është mbi çdo vendimi tjetër dhe është detyrim po nuk u zbatua dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese atëherë ka marrë fund.

Z.Th.Sallaku:Për saktësi e para nuk është e njëjntë rasti që përmendi rastin që po e shqyrtojmë, por unë mendoj që Prokuroria në verifikimin e tij është shprehur fare qartë nuk rezulton që ndaj tij të ketë marrë masa dëbimi në një shtet i huaj. Unë mendoj se është një document zyrtar interpretuar nga organi kompetent si Prokuroria e Përgjithshme dhe mbyllet me kaq mendoj unë.

Z.A.Kaziaj: Më vjen shumë keq po ky është një lapsus shumë i madh i Prokurorisë së Përgjithshme që në pjesën e dispozitivit të vet unë e citova në fjalën hyrëse

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

timen shënon gabimisht rezulton që të jetë marrë masë dëbimi kur vet në të njëjtin dokument referuar faqes 4, thotë që është regjistruar në datën 27.03.2017 dhe pasi është deportuar. Deportimi në vetvete nuk është dëbim? A është kusht ndalues thashë e keni zotin Hajdari këtu të na japë një përgjigje nëse e mban mend mirë kur ka qenë i mitur nuk mban mend ndonëse se ka qenë prezent në gjykatë dhe ka marrë vendimmarrjen aty për aty nga gjyqtari shtetin grek, po në vitin 2017 që ka qenë madhor a mban mend të jetë deportuar dhe për cilin fakt është deportuar zoti Hajdari në Shqipëri.

Z.Th.Sallaku: Ne jemi në një seancë me karakter administrative kuadri i gjykatës siç është dhe rasti në fjalë nuk jemi këtu për spektakël meqënëse janë kamerat nëse ka problematika, kam bërë dhe kallëzim penal dhe do të sqarohen me qetësi në vazhdim.

Z.A.Llongozi: Mund të sqaroj diçka, këtu nuk jemi përpara bërjes së një spektakli por jemi përpara një detyre që e imponon ligji zotin Hajdari të japë shpjegim institucioneve shtetërore, publikut edhe mbarë njerëzve që e kanë votuar apo që presin të bëhet drejtësi apo duhet të ishte një kandidat tjetër në vendin e tij kështu që është detyrim ligjor, vetë ligji i posaçshëm e detyron zotin Hajdari të japë shpjegime dhe jo të bëhet show. Show e ka bërë duke sjellë të tilla rezultate në këtë seancë.

Z.I.Celibashi: Unë mendoj që ta përfundojmë nuk besoj që secila prej palëve ka lënë diçka pa thënë dhe të vazhdojmë me vlerësimin nga ana jonë të pretendimeve të palëve në lidhje me këtë çështje. Nuk besoj se kemi gjë tjetër. E përfundojmë hetimin administrativ për këtë çështje dhe vlerësimi ynë në lidhje me pretendimet e

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

palëve për këtë çështje është si vijon është e qartë që ligji nr.138 i vitit 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen dhe ushtrohen funksione publike ka për qëllim që në zyrën e shtetit të ulen persona të cilët plotësojnë disa kushte dhe kritere të tilla që bëjnë të besueshëm veprimtarinë e këtij personi në zyrën përkatëse qoftë ky i zgjedhur apo qoftë funksional publik i emëruar për rastet ky ligj ka përcaktuar detyrimin për të bërë publike çdo të dhënë që lidhet me veprimtarinë e këtyre personave. Në nenin 5 të këtij ligji pika 1 është përcaktuar personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3 të këtij ligji, pra janë e gjithë kategoria e atyre subjekteve të cilët i nënshtrohen veprimet e këtij ligji duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetdeklarimi me anë të të cilit deklarojnë mos ekzistencën e shkaqeve për të kandiduar për të mos u zgjedhur apo mos emëruar. Pra sipas përcaktimit të këtij neni detyrimi i këtyre subjekteve është për të deklaruar shkaqet kur ka shkaqe të cilat e ndalojnë atë që të marrë një funksion publik. Në të kundërt kjo do të thotë nëse shkaqet mungojnë nuk ka asnjë detyrim për subjektin në fjalë që të deklarojë çdo gjë tjetër që nuk përbën shkak për ndalim për të marrë një funksion publik. Jemi para një fakti ku subjekti vetdeklarues tashmë Kryetar i Bashkisë së Kuçovës por në momentin e paraqitjes së formularit të vetdeklarimit ka qenë kandidat për kryetar të bashkisë ka paraqitur formularin e vetdeklarimit dhe në atë formular ka paraqitur disa të dhëna. Në gjykimin dhe vlerësimin e tij është llogjike për çdo rast të tij ai nuk ka paraqitur një të dhënë që lidhet me një process penal administrative të themi po është vendim penal në një kohë të caktuar të zhvilluar ndaj tij në drejtorin e republikës greke dhe në vlerësim të tij kjo la qenë e panevojshme për t'u deklaruar ose e ka harruar dhe nuk ka rëndësi në arsyetimin tonë ky element, por ajo çfarë ka rëndësi është se kjo e dhënë nuk përbën tashmë e certifikuar kjo e dhënë edhe nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme sipas përcaktimeve të ligjit nuk e përfshin atë në kushtet e ndalimit

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

për shkak të veprës penale për cilët ai ka marrë dënimin përkatës. Ngelet diskutimi që fakti që ai nuk e ka deklaruar edhe pse në vetvete se besoj se pala tjetër e pranoi nuk jemi diskutuar as për llojin e veprës penale as për masën e dënimit, por jemi diskutuar për faktin që ky në çdo rrethanë ka pasur detyrime që ta deklaronte këtë të dhënë dhe i ngelej pastaj organit kompetent KQZ-së ose mandej gjykatës për të vlerësuar nëse ishte apo jo në kushtet e ndalimit. Edhe në respektim të precedëve të krijuar nga ky institucion që prej vitit 2020 që unë të paktë3n jam në detyrën e Komisionerit Shtetëror ne kemi mbajtur qëndrime që nuk ka detyrim subjekti vetdeklarues për të paraqitur në formularin e vetdeklarimit rrethana apo shkaqe të cilat nuk e ndalojnë atë që të marrë zyrën publike. Ky është një qëndrim tashmë i konsoliduar prej institucionit të KQZ-së janë disa raste më recent është ai i kandidatit për deputet të Kolacionit Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim zotit Zef Hila, i cili të gjitha pyetjet që lidhen me ndalime arrestime apo precedime është përgjigjur me jo sepse natyrshëm të gjitha ato rrethana nuk e pengonin atë për të kandiduar si deputet janë disa raste tjera. Përtej faktit që kjo është një praktikë e konsoliduar e këtij institucioni në vlerësimin tim qëndron bindja që një subjekt i cili ka detyrimin për shkak të angazhimit që kërkon të marrë një zyrë publike të plotësojë një formular vetdeklarimi nuk ka detyrimin të përfshijë të dhënat të cilat nuk përbëjnë shkak për të kandiduar në rastin konkret. Vlerësoj që nuk ka një shkak ligjor që Kryetarit i Bashkisë Kuçovë t'i ndërpritet mandate përtej faktit që nenit 5 pika 3 thotë formulari i vetdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekti i këtij ligjit dhe mandej shton deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrëmbuara përbën veprë penale sipas nenit 190 të Kodit Penal por jo është një çështje që nuk i takon në mënyrë absolute Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ajo çfarë vlerëson Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është verifikimi i shkaqeve për mos kandidim të një personi të caktuar. Në rastin konkret këto

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

mungojnë. Kundër këtij vendimi keni të drejtë brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit për kontributet tuaja. Ditën e mirë.

Vendimi nr.816

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

14.11.2023
Ora 12:41

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatën nga lista shumëemërore të subjektit “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, zoti Aleksandër Nikoll Frroku

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj.P.Docaj**


• **Parti Politike:**

• **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me rendin e ditës.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Pukë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave nga këshilltarët e subjekteve të ndryshme, kandidati fitues nga listat shumë emërore e këtyre subjekteve politike të cilët i kalon mandati i këshilltarit, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit si organi kompetent për verifikimin e ndalimeve në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimet në parashikimet të ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore ku

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje se nuk ka ndryshime përbërëse i Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidatët duke rrëzuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2 të kreut 5 të vendimit nr17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për Bashkinë Pukë nuk është në kushtet e mos zgjedhjes së kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendim për shqyrtim dhe miratim.

Z.I.Celibashi: Vendosim plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë me kandidatin nga lista shumëemërore të subjektit Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, zoti Aleksandër Frroku.

Vendimi nr.817

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

14.11.2023
Ora 12:41

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak, me kandidatin nga lista shumëemërore të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zoti Kadri Abdulla Metaliu

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merhaj, Znj.P.Docaj**

• **Parti Politike:**

• **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merhaj: Këshilli i Bashkisë Shijak ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave nga këshilltarët e subjekteve të ndryshme, kandidati fitues nga listat shumë emërore e këtyre subjekteve politike të cilët i kalon mandati i këshilltarit kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit si organi kompetent për verifikimin e ndalimeve në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimet në parashikimet të ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore ku

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje se nuk ka ndryshime përbërëse i Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidatët duke rrëzuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2 të kreut 5 të vendimit nr17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për Bashkinë Shijak nuk është në kushtet e mos zgjedhjes së kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendim për shqyrtim dhe miratim.

Z.I.Celibashi: Vendosim plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak me kandidatin nga lista shumëemërore të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë zoti Abdulla Metalia.

Vendimi nr.818

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

**14.11.2023
Ora 12:43**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumëemërore të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, znj.Xheni Namik Hatillari

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj.P.Docaj**


• **Parti Politike:**

• **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tiranë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave nga këshilltarët e subjekteve të ndryshme, kandidati fitues nga listat shumë emërore e këtyre subjekteve politike të cilët i kalon mandati i këshilltarit kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit si organi kompetent për verifikimin e ndalimeve në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimet në parashikimet të ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore ku

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje se nuk ka ndryshime përbërëse i Gjendjes Civile Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidatët duke rrëzuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2 të kreut 5 të vendimit nr17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për Bashkinë Tiranë nuk është në kushtet e mos zgjedhjes së kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendim për shqyrtim dhe miratim.

Z.I.Celibashi: Vendosim plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidaten nga lista shumëemërore të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë zonja Xheni Hatillari.

Vendimi nr.819

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

14.11.2023

Ora 12:44

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidaten nga lista shumëemërore të subjektit “Partia Agrare Ambientaliste”, znj. Giela Bardhi Hoxhalli

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj.P.Docaj**

• **Parti Politike:**

• **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Devoll ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave nga këshilltarët e subjekteve të ndryshme, kandidati fitues nga listat shumë emërore e këtyre subjekteve politike të cilët i kalon mandati i këshilltarit kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit si organi kompetent për verifikimin e ndalimeve në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimet në parashikimet të ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore ku

**Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.11.2023*

në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje se nuk ka ndryshime përbërëse i Gjendjes Civile përveç kandidatit të Bashkisë Devoll, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidatët duke rrëzuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2 të kreut 5 të vendimit nr17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për Bashkinë Devoll nuk është në kushtet e mos zgjedhjes së kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendim për shqyrtim dhe miratim.

Z.I.Celibashi: Vendosim plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll me kandidaten nga lista shumëemërore të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë zonja Giela Hoxhalli.

Vendimi 820

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*

